



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 618/9 Prot.

Durrës, më 05.03.2026

V E N D I M

Nr. 30, Datë 05.03.2026

PËR

**"RIORGANIZIM NË MASËN NËN 20% TË PROGRAMIT ME KARAKTER
PROFESIONAL 2- VJEÇAR NË "ASISTENT ADMINISTRATIV", PRANË
FAKULTETIT TË STUDIMEVE PROFESIONALE, UNIVERSITETI
"ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; referuar shkresës së Fakultetit të Studimeve Profesionale me nr. 2705 prot., datë 20.11.2025, si dhe referuar relacionit nr. 401 prot., datë 12.02.2026 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 05.03.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e riorganizimit në masën nën 20% të programit me karakter profesional 2-vjeçar në "Asistent Administrativ", pranë Departamentit të Studimeve të Integruara me Praktikën (DESTIP), të Fakultetit të Studimeve Profesionale, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore, FSP
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2026-2027.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

